

VENDIM
Nr.1290, datë 23.12.2009

PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE BAZË,TË SEKTORËVE QË DO TË
MBËSHTETEN DHE TË MASAVE TË PËRFITIMIT NGA FONDI I PROGRAMIT PËR
BUJQËSINË DHE ZHVILLIMIN RURAL

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3 të nenit 6 të ligjit nr.9817, datë 22.10.2007 “Për bujqësinë dhe zhvillimin rural” dhe të ligjit nr.10190, datë 26.11.2009 “Për buxhetin e vitit 2010”, me propozimin e Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Fondet e miratuara në buxhetin e vitit 2010 për Ministrinë e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, zëri “Transferte në buxhetet familjare”, të përdoren për mbështetjen e prodhimit bujqësor, blegtoral dhe të agropërpunimit.

2. Sektorët, që do të mbështeten nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural, të jenë:

- a) Mbjellja e ullishtave, pemëtoreve dhe vreshtave.
- b) Prodhimi i fidanëve të certifikuar të ullirit.
- c) Zbatimi i teknologjive moderne të ujitjes.
- ç) Prodhimi i perimeve në serat diellore.
- d) Prodhimi blegtoral.
- dh) Prodhimi i produkteve bio.
- e) Prodhimi i vajit të ullirit.
- ë) Nxitja e kreditimit bankar në sektorin e bujqësisë.

3. Masa e përfitimit të drejtpërdrejtë nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural, sipas kriterëve, të jetë, si më poshtë vijon:

- Mbjellja e ullinjve, agrumeve dhe pemëve frutore, 250 000 (dyqind e pesëdhjetë mijë) lekë/ha, për format tradicionale dhe 350 000 (treqind e pesëdhjetë mijë) lekë/ha për format intensive të kultivimit të tyre. Sipërfaqja e mbjellë duhet të jetë jo më pak se 2 (dy) dynym.

- Mbjellja e vreshtave, 500 000 (pesëqind mijë) lekë/ ha. Sipërfaqja e mbjellë duhet të jetë jo më pak se 2 (dy) dynym.

- Ujitja me pika në pemëtore, agrumishte dhe ullishte intensive, në masën 300 000 (treqind mijë) lekë/ha, për sipërfaqet jo më të vogla se 2 (dy) dynym.

- Prodhimi i produkteve bujqësore bio nga bimët e kultivuara, 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë/fermë në vit.

- Blerja e plastmasit për serrat me ngrohje diellore dhe teknike, 200 000 (dyqind mijë) lekë/ha serrë, për sipërfaqet jo më të vogla se 2 (dy) dynym.

- Pagesa me 10 lekë/litri, qumësht, për fermtat blegtorale, që mbarështojnë 10-50 krerë lopë qumështi të racave të pastra dhe kryqëzimet e tyre. Pagesa të bëhet kundrejt sasisë së qumështit të deklaruar në organet tatimore.

- Pagesa 500 (pesëqind) lekë për kokë dele, për tufat me mbi 50 krerë, të matrikulluara.

- Prodhimi i vajit të ullirit extra-vergine, 100 (një qind) lekë/litri për sasi të deri në 15 tonë/viti.

5. Nxitjen e kreditimit bankar në sektorin e bujqësisë për:

- mbështetjen, përmes subvencionimit, në masën 70 % të normës së interesit, për 3 vite radhazi, për kreditë, deri në 15 000 000 (pesëmbëdhjetë milionë) lekë, që do të merren për ruajtje dhe përpunim të produkteve, bujqësore dhe blegtorale, si dhe për mjete mekanike bujqësore.

- krijimin e fondit të garancisë për kreditimin e veprimtarive bujqësore të agroindustrisë dhe të atyre të orientuara për eksport, në masën 50 % të vlerës së principalit të kredisë. Garancia bëhet për kreditë deri në 15 000 000 (pesëmbëdhjetë milionë) lekë.

6. Procedura dhe mënyra e administrimit të fondit të programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural përcaktohen me udhëzim të përbashkët të Ministrit të Financave dhe të Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

7. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha